



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_274_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_414_05_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_414_05_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Dibran Hyseni (shifra e konsumatorit DMI – 27745) nga Vushtrria, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 14.12.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 23.05.2008 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 16.01.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për kontrollimin e pikave matëse, kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të dëmtuara dhe se kanë kërkuar nga konsumatori të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik në afatin e paraparë.

Provë: Procesverbali i kontrollës nr. 060234 i datës 16.01.2007

- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar kërkesë në KEK për ndërrimin njehsorit me nr. 17667393.
Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori.
- Me datë 10.04.2008 me kërkesë të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë vendosur për matje njehsorin e ri nr. 44664063 dhe kanë theksuar se njehsori i vjetër me nr. 17667393 nuk prezantohet.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 001140 datë 10.04.2008
- Me datë 18.04.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DMI08HP01545 në vlerë prej 2,546.79 €.
Provë: Fatura DMI08HP01545 e datës 18.04.2008
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 23.05.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 13.05.2008
- Me datë 14.12.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 414_05_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

